

Pergjigjet per pyetjet nga "Qendra Shqiptare per Gazetari Cilesore".

1-Sa është fondi i vendosur në dispozicion për realizimin e programit të kodimit?

Në zbatim të të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 646, datë 5.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”, për vitin 2023, fondi i parashikuar është 100.000.000 lekë, për të mbështetur pjesëmarrjen e 1000 pjesenarrësve në kurset e Programimit.

2-Kur është celur dhe kur mbyllet thirrja?

Aplikimi për të marrë pjesë në programin e kodimit është hapur në Janar të vitit 2023 dhe qëndron i hapur gjatë gjithë vitit kalendarik. Aplikimi bëhet në rrugë elektronike në portalin qeveritar e-Albania në link-un: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15126.

3- Sa është numri i të rinjve të regjistruar deri më tani në këtë program?

Për periudhën Janar – Maj 2023, Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nëpërmjet Zyrave të Punës ka shqyrtuar 3140, ku 799 aplikantë kanë pranuar të marrin pjesë në këtë program. Nga këto, institucionet e formimit profesional i kualifikuar për ofrimin e kurseve me mbështetje financiare ka kryer testimet paraprake dhe intervistën, ku 498 aplikantë kanë arritur ta kalojnë këtë fazë dhe aktualisht 393 aplikantë janë duke ndjekur kursin për të cilin kanë aplikuar.

4 - Sa prej tyre e fitojne 100% të paguar programin?

49 kursantë që po ndjekin kurset profesionale janë duke përfituar financim 100% të kostos së kursit të formimit profesional.

5 -Sa është numri maksimal i të rinjve që mund të regjistrohen në programin e kodimit dhe cilat janë kriteret e pranimit të tyre?

Programi i Kodimit synon kualifikimin dhe rikualifikimin e pjesëmarrësve me qëllim përgatitjen për integrim të shpejtë në tregun e punës. Me fondin e parashikuar për këtë vit synohet të mbështetet pjesëmarrja e 1000 personave, në kurset e Programimit. Kriteri që duhet të plotësojnë aplikantët për tu regjistruar në këtë program është mosha 16 vjeç dhe përfundimi me sukses i intervistës dhe testimit paraprak të zhvilluar nga institucioni i formimit profesional që ka përzgjedhur gjatë aplikimit në e-albania.